

AKT THEMELIMI
i shoqërisë "U.A.A Distribution" Sh.p.k.

Sot, me datë 01/02/2021,

- **Z. Klodian Merko**, shtetas shqiptar, atësia Bashkim, lindur në Tiranë, më 24/01/1980, banues në Rruga "Dritan Hoxha", Banesa Nr. 3, Pranë Fiat, Laprakë, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 036190515, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Besar Rufi**, shtetas shqiptar, atësia Pëllumb, lindur në Tiranë, më 23/07/1989, banues në Rruga "Pjetër Budi", P 56/1, Sh. 1, Ap. 1, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 034052583, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Denis Husi**, shtetas shqiptar, atësia Jetmir, lindur në Tiranë, më 01/09/1988, banues në Rruga "Qemal Stafa", P 54/3, Sh. 2, Ap. 8, Tiranë, mbajtës i Pashaportës me nr. BA0846234, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Antonio Sadiku**, shtetas shqiptar, atësia Roland, lindur në Korçë, më 08/08/1989, banues në Rruga Dibrës, P 369/2, prapa Medresesë, Kati 8, Ap. 35, Tiranë, mbajtës i Pashaportës me nr. BG8100288, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Zj. Selamije Dinaku**, shtetase shqiptare, atësia Smajl, lindur në Shkodër, më 03/04/1962, banuese në Rruga "Sali Butka", P. Nord Konstruksion, Sh. 2, Ap. 11, Tiranë, mbajtëse e Pashaportës me nr. BD9073067, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Znj. Aristeia Dinaku**, shtetase shqiptare, atësia Shlirim, lindur në Shkodër, më 21/05/1991, banuese në Rruga "Sali Butka", P. Nord Konstruksion, Sh. 2, Ap. 11, Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit me nr. 034023304, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "U.A.A Distribution" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").


NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "U.A.A Distribution" Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia nr 1, Rruga "Murat Toptani", pedonale brenda Kalasë së Tiranës, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.



Klodian Merko

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Shërbimet në fushën e Import-Eksportit të të gjitha mallrave industriale, veshëmbathjeve, këpucëve, të veshjeve të të gjitha llojeve pa kufizim.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin.


Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 25.000.000 (njëzet e pesë milion) Lekë dhe është i ndarë në 5 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Klodian Merko**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 6.250.000 (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 6.250.000 (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Besar Rufi**, zotëron 1 kuotë, me 20% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 5.000.000 (pesë milion) Lekë dhe 5.000.000 (pesë milion) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Denis Husi**, zotëron 1 kuotë, me 20% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 5.000.000 (pesë milion) Lekë dhe 5.000.000 (pesë milion) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Antonio Sadiku**, zotëron 1 kuotë, me 20% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 5.000.000 (pesë milion) Lekë dhe 5.000.000 (pesë milion) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Zj. Selamije Dinaku**, zotëron 1 kuotë, me 10% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Znj. Aristeja Dinaku** zotëron 1 kuotë, me 5% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.



Handwritten signatures in blue ink, corresponding to the names listed in the previous block: Besar Rufi, Denis Husi, Antonio Sadiku, Selamije Dinaku, and Klodian Merko.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/rët që emërohen nga Asambleja e ortakëve. Administrator i shoqërisë është **Zj. Selamije Dinaku**, shtetase shqiptare, lindur më 03/04/1962, në Shkodër, banuese në Tiranë, mbajtëse e dokumentit Pashaportë me nr. BD9073067 dhe Nr. Personal G25403040E, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Zj. Selamije Dinaku** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë

ORTAKËT THEMELUES

KLODIAN MERKO

Klodian Merko

BESAR RUFİ

Besar Rufe

DENIS HUSI

Denis Husi

ANTONIO SADIKU

Antonio Sadiku

SELAMIJE DINAKU

Selamije Dinaku

ARISTEA DINAKU

Aristea Dinaku

Aristea Dinaku